




Centre for Research,
Documentation and Publication

MEMORIALIZIMI I PASLUFTËS DHE BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS



Prishtinë, Kosovë
Shtator 2015



Centre for Research,
Documentation and Publication

Memorializimi i pasluftës dhe Ballafaqimi me të Kaluarën në Republikën e Kosovës

Prishtinë, Kosovë
Shtator 2015

Titulli: Memorializimi i pasluftës dhe Ballafaqimi me të Kaluarën në Republikën e Kosovës

Autor: Jude Sweeney, nën mbikëqyrjen e Nora Ahmetaj

Publikuar: Shtator 2015

Botim i Qendrës për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP). Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak më shkrim nga ana e botuesit.

Ky draft është subjekt për hulumtime të mëtutjeshme.

Botuar nga: Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP), Nora Ahmetaj; Rr. "Shaban Polluzha" Nr.7, Prishtinë, Kosovë 10000; Tel: +377 45 321 545; info@crdp-ks.org; www. crdp-ks.org.



CHARLES STEWART

MOTT FOUNDATION

Përmbajtja e këtij publikimi pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorëve, që janë përgjegjës për faktet dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jodomosdoshmërisht përfaqësojnë ato të Charles Stewart MOTT Foundation.

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| i. Akronimet | 5 |
| 1. Hyrje | 6 |
| 2. Rekomandimet | 7 |
| 3. Memorializimi | 8 |
| 3.1 Përkufizimi i Memorializimit | 8 |
| 3.2 Lidhja e Memorializimit me Drejtësinë Tranzicionale | 9 |
| 4. Metodologjia | 11 |
| 5. Politikat Zyrtare të Memorializimit në Kosovë | 12 |
| 6. Analiza | 12 |
| 6.1 Kujtesa nuk është e institucionalizuar | 12 |
| 6.2 Qasja etno-nacionaliste | 13 |
| 6.3 Qasja estetike socio – realiste dhe gjinore | 14 |
| 6.4 Qasja individualiste | 16 |
| 6.5 Një Ligj i ri | 17 |
| 6.6 Një Praktikë e re | 18 |
| 6.7 Një Filozofi e re | 19 |
| 7. Përfundim | 21 |
| 8. Bibliografia | 22 |

i. AKRONIMET

| | |
|--------|--|
| BE | Bashkimi Evropian |
| UÇK | Ushtria Çlirimtare e Kosovës |
| QNDT | Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale |
| “ICTY” | Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë |
| “NATO” | Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior |
| OJQ | Organizatë Jo – Qeveritare |
| PDK | Partia Demokratike e Kosovës |
| “UN” | Kombet e Bashkuara |
| “UNDP” | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim |

1. HYRJE

Në Shoqëritë e dala nga konflikti masat e drejtësisë tranzicionale janë pjesë thelbësore e proceseve të shtet-ndërtimit dhe demokratizimit.¹ Diskutimi akademik gjithnjë e më shumë fokusohet në rolin e drejtësisë tranzicionale në ndërtimin e paqes. Megjithatë besimi se masat e drejtësisë tranzicionale mund të ndihmojnë këto procese ka qenë subjekt i shumë debateve dhe kritikave. Tani konsiderohet gjerësisht se në mënyrë që drejtësia tranzicionale të luaj një rol të rëndësishëm në zhvillimin e konteksteve të pas luftës, duhet marrë një qasje gjithëpërfshirëse. Kjo përfshinë një fokus në masat përtej qasjes tradicionale juridike ndaj drejtësisë, nga lart – poshtë, masat që janë më restorative dhe që përfshijnë komunitetin e gjerë, si dhe masat që adresojnë çështje afatgjate të padrejtësive sociale. Një kuptim gjithëpërfshirës lejon shqyrtimin e një game të gjerë të masave që mund të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve të drejtësisë tranzicionale. Memorializimi është një shembull që mund t'i ndihmoj proceset e drejtësisë, por ky shpesh neglizhohet.

Në Kosovë nuk ka përpjekje për të përfshirë praktikën e memorializimit në kornizën e drejtësisë tranzicionale. Memorializimi në Kosovë, jo vetëm që po dështon për të kontribuar drejt ballafaqimit me të kaluarën por karakteri i tij etno-nacionalist, që reflekton një interpretim përkrahës të së kaluarës, ndoshta pengon çdo proces të tillë.

Qëllimet kryesore të këtij punimi janë **1)** të shqyrtoj qasjen aktuale të memorializimit në Kosovën e pasluftës, duke u fokusuar në atë se si është paraqitur e kaluara; **2)** për të gjetur në mënyrë të qartë motivin e memorializimit në kontekstin e drejtësisë tranzicionale. Këto synime janë të destinuara për të nxitur reflektimin mbi lidhjet midis memorializimit dhe ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë.

Të gjeturat nga kjo analizë japin një sërë rekomandimesh në atë se si të zhvillohen politika më konstruktive ndaj memorializimit të pasluftës në Kosovë.

Pjesa e parë e këtij punimi jep sfondin teorik për temën e memorializimit, dhe rolin e memorializimit brenda një strategjie të drejtësisë tranzicionale. Pjesa e dytë e punimit jep analizat e peizazhit të tanishëm të kujtesës së Kosovës. Analiza së pari thekson shqetësimet kryesore në lidhje me qasjen bashkëkohore ndaj memorializimit në Kosovë. Pastaj do të argumentoj se për të ndërtuar një kulturë të përkujtimit që do të kontribuojë drejt një procesi më të gjerë të ballafaqimit me të kaluarën duhet të zhvillohet një ligj i ri, një praktikë e re dhe një filozofi e re drejt memorializimit.

¹Në thelb drejtësia tranzicionale i referohet mënyrës në të cilën shteti arrinë drejtësi gjatë periudhave të tranzicionit nga e kaluara e dhunshme. Kombet e Bashkuara (OKB, 2010) e përkufizojnë drejtësinë tranzicionale si të përbërë: nga të dyja proceset gjyqësore dhe jo-gjyqësore dhe mekanizmat, përfshirë iniciativat e prokurorisë, duke lehtësuar iniciativën në lidhje me të drejtën për të vërtetën, duke dhënë reperacione, reforma institucionale dhe konsultime nacionale. Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ, 2014) miraton një përkufizim të ngjashëm duke shpjeguar se: drejtësia tranzicionale i referohet një sërë masash gjyqësore dhe jo-gjyqësore që janë zbatuar nga vende të ndryshme, në mënyrë që të mënjanojnë trashëgiminë e abuzimeve masive të të drejtave të njeriut. Këto masa përfshijnë ndjekjet penale, komisionet e së vërtetës, programet e reparacioneve, dhe lloje të ndryshme të reformës institucionale.

2. REKOMANDIMET

QHDP avokon për krijimin e legjislacionit që ofron një kornizë për zhvillimin e kulturës së përkujtimit në Kosovë. Ne argumentojmë për njohjen e lidhjes mes memorializimit dhe ballafaqimit me të kaluarën. Rëndësia e një politike konstruktive mbi memorializimin, duke përfshirë caktimin e një dite kombëtare të përkujtimit, nuk duhet të nënvlerësohet. QHDP thekson se ky është një hap jetik në arritjen e rritjes së ndërgjegjësimit në mesin e qytetarëve të tanishëm dhe të ardhshëm të Kosovës, për nevojën e adresimit të së kaluarës në mënyrë gjithpërfshirëse. Kosova vazhdon të jetë e fokusuar në qëllimin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Demonstrimi i një aganzhimi më të madh në adresimin e së kaluarës është vendimtar për një proces efektiv të anëtarësimit në BE. Një politikë e përmirësuar mbi memorializimin do të kontribuojë në realizimin e këtij qëllimi.

1. **Krijimi** i një kornize ligjore në lidhje me ndërtimin e memorialeve të ardhshme.
 - Ligji duhet të vendosë se kush është përgjegjës për ndërtimin e memorialeve në Kosovë.
 - Ligji duhet të vendosë se kush është përgjegjës për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e memorialeve në Kosovë.
 - Ligji duhet të përcaktojë standardet që qartësojnë mesazhin social që promovohet; mesazhi social duhet të mbështesë parimin e përfshirjes dhe të shmangë simbolet e përkatësisë etnike.
 - Duhet të deklarohet qëllimi dhe objektivat e memorialeve.
2. Duhet të krijohet një bazë e të dhënave që përmban informacion mbi memorialet ekzistuese në tërë Kosovën.
3. Duhet të hapen thirrjet për propozime për projekte mbi memorializimin me konkurs ndërkombëtar - konkurrenca e fortë stimulon nxitje për një dizajn më të mirë. Kjo duhet të pasqyrohet në ligj.
4. Duhet të krijohet një ditë kombëtare e përkujtimit për të gjitha viktimat e konfliktit.
5. Projektet e ardhshme të memorializimit duhet të përfshijnë një gamë të akterëve.
 - Të përfshihen në proces të mbijetuarit/at e dhunës – pronësia vendore duhet të shtohet.
 - Të konsultohen të gjitha palët, duke përfshirë komunitetet lokale, OJQ-të, grupet e viktimave, komunitat, artistët, historianët dhe grupet e të rinjve.
6. Duhet të vendosen lidhje mes vendndodhjeve të memorialeve dhe programeve të edukimit.
 - Te integrohen programet e edukimit – si formale dhe joformale, me vendndodhjet e memorialeve, për të nxitur një dialog kritik mbi të kaluarën.
 - Të shfrytëzohet potencialin për të përdorur vendet përkujtimore për edukimin lidhur me luftën dhe konfliktin në nivel global dhe çështjet bashkëkohore të të drejtave të njeriut.
7. Memorialet si të tilla nuk duhet të shihen si të mjaftueshme në adresimin e gabimeve të kaluara; p.sh. *Heroinat*.²

²*Heroinat* është memoriali zyrtar i dedikuar për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë viteve 1998-9. Projekti ishte sponsorizuar nga Qeveria. U inaugurua më 12 qershor 2015 në qendër të Prishtinës. Diskutohet më vonë në këtë punim.

3. MEMORIALIZIMI

3.1 PËRKUFIZIMI I MEMORIALIZIMIT

Praktikat komemorative zhvendosin aktin e përkujtimit nga gjendja mendore në aktivitet. Memorializimi bëhet kornizë e prekshme për aktin e përkujtimit.³ Pierre Nora ka shpikur frazën *lieux de memoire* (vendet e kujtesës), duke iu referuar dëshirës për të ruajtur sende të prekshme për t'i mbajtur aktive kujtimet e kaluara brenda “ndërgjegjes popullore”. Kujtimet zhvillohen si rezultat i shikimit të formave kulturore, por ato edhe iu atribuohen formave kulturore. Këto forma përdoren për të ndërtuar marrëdhënie me të kaluarën dhe përceptime për të.⁴ Muzetë, memorialet, ekspozitat, rrënojat e konservuara, filmat, emërtimet e rrugëve, ditët përkujtimore dhe ceremonitë, të gjitha janë forma të memorialit⁵. Të gjitha këto janë të afta për të artikuluar një të kaluar dhe për të formësuar kujtimet, dhe si rezultat, tregimet për të ardhmen. Këto institucione të ‘kujtesës kulturore’⁶ veprojnë në mënyrë efektive si një arkiv i kujtimeve të ruajtura, të cilat më pas riaktivizohen për t’u bërë pjesë e kujtesës kolektive.

Tradicionalisht muzetë dhe memorialet kanë ekzistuar për të mbështetur rrëfimet historike kombëtare. Ato kanë ndihmuar për të përcaktuar identitetin kombëtar dhe shpesh kanë treguar rrëfenja heroike kombëtare. Në shoqëritë bashkëkohore gjithnjë e më rrallë këto kanë një autoritet të tillë⁷. Duke ndjekur shembullin e memorializimit të Holokaustit, muzetë dhe memorialet tani shpesh qëndrojnë si praniam i fajit, duke i dhënë prioritet përkujtimit të viktimeve, njëkohësisht duke vepruar si paralajmërim për brezat e ardhshëm. Zhvillime të këtilla brenda fushës së muzeologjisë dhe memorializimit kanë bërë që muze të historisë të zëvendësohen nga të ashtuquajtur ‘muze të kujtesës’ dhe ‘muze të memorialeve’.⁸ Këto janë definuar jo vetëm si;

“lokacione të historisë akademike dhe institucionale por hapësira të kujtesës, duke u bërë shembull i kalimit nga diskursi autoritativ i perceptuar mbi të kaluarën, në paradigmen e kujtesës që gjoja lejon një gamë më të gjerë të tregimeve rreth së kaluarës.”⁹

Sugjerimi se memorialet gjithnjë e më shumë lejojnë një gamë më të gjerë të tregimeve rreth së kaluarës, duhet të shihet me skepticism. Në shoqëritë e dala nga konflikti, shpesh ekziston një dëshirë për të promovuar një tregim të veçantë përmes manipulimit të së kaluarës, në mënyrë që të

³Andrew Jones, *Memory and Material Culture* (Kujtesa dhe kultura materiale), 2007, f45.

⁴Barbara Misztal, ‘Collective Memory in a Global Age: Learning How and What to Remember’ (Memoria kolektive në kohën globale: Duke mëuar si dhe çfarë të kujtohet), *Current Sociology*, 58 (1): 24-44, 2010.

⁵Dacia Viejo-Rose, Memorial functions: Intent, impact and the right to remember (Funkcionet e memorialit: qëllimi, ndikimi dhe e drejta për të kujtuar), *Memory Studies*, 4 (4): 465-480, 2011, f466.

⁶Jan Assman, ‘Communicative and Cultural Memory’ (Kujtesa komunikuese dhe kulturore), in Astrid Erll and Ansgar Nünning (eds.), *Cultural Studies: An Interdisciplinary Handbook*, 2008, f109.

⁷Silke Arnold-de Simone, ‘Memory Museum and Museum Text: Intermediality in Daniel Libeskind’s Jewish Museum and W.G Sebald’s Austerlitz’, *Theory, Culture and Society*, 29 (1): 14-35, 2012, f15.

⁸Simone, 2012, p15.

⁹Simone, 2012, p15.

legjitimohet rendi i tanishëm politik. Për shembull, një memorial për viktimat Tutsi të gjenocidit në Ruandë nuk përshinë njohjen e 200 000 viktimave Hutu të represionit të mëvonshëm. Burgu i Kham në Libanin Jugor ekziston si një vend përkujtimor për viktimat e konfliktit, por njëkohësisht denoncon armikun. Mbishkrimi në Irlandën Veriore përkujton grupe të veçanta, 'dëshmorët' dhe 'heronjtë', në këtë mënyrë promovon reflektim të njëanshëm për të kaluarën¹⁰. Si rrjedhojë, përderisa memorializimi ka kapacitet që të përkrahë një proces të ballafaqimit konstruktiv me të kaluarën, gjithashtu mund të veprojë si pengesë. Rrëfimi që i përshtatet rendit mbizotërues politik ka mundësi të jetë në dëm të komuniteteve të marginalizuara. Përforcon ndjenjën e viktimizimit dhe padrejtësisë të një grupi të veçantë, dhe inkurajon jotolerancë etnike. Memorialet e japin mundësinë për të akuzuar të tjerët dhe njëkohësisht promovojnë një agjendë të veçantë ideologjike. Memorialet që vazhdimisht përforcojnë një rrëfim viktimë/autor i krimit dhe mbështesin idenë e 'tjetërsisë' vazhdojnë shkaktimin e ndarjeve sociale dhe mund t'i japin shtytje apo edhe të legjitimojnë dhunën e mëtejshme. Prandaj memorializimi është një proces tejet i politizuar dhe i ndjeshëm.

3.2 LIDHJA E MEMORIALIZIMIT ME DREJTËSI TRANZICIONALE

Paradigma e drejtësisë tranzicionale në mënyrë të pashmangshme përkon me paradigmen e kujtesës, pasi të dyja mbështeten në dokumentimin, ruajtjen dhe paraqitjen e së kaluarës. Pavarësisht kësaj lidhjeje, memorializimi si mishërim i prekshëm i aktit të të përkujtuarit, për një kohë të gjatë ka qenë i anashkaluar si komponent me vlerë i drejtësisë tranzicionale. Përderisa po rritet niveli i presionit ndërkombëtarë mbi shtetet për të përkujtuar mizoritë nga e kaluara, një theks më i madh është vënë mbi rolin e memorializimit brenda kornizës së drejtësisë tranzicionale, dhe standardet për rolin e shtetit në praktikën e memorializimit kanë filluar të bëhen më të zakonshme.¹¹ Kjo është ilustruar nga fakti se komisionet për të vërtetën në mënyrë eksplicite e kanë njohur vlerën e memorialeve si mjet simbolik të dëmshpërblimit për pasojat e konfliktit.¹² Standarde të caktuara të Kombeve të Bashkuara, tashmë edhe insistojnë në obligimin e të përkujtuarit.¹³

Një theks në rritje mbi rolin e memorializimit në shoqëritë pas-konfliktit është pjesërisht një përgjigje për rritjen e vëmendjes për format e drejtësisë restorative. Diskursi ligjor dhe politik dominon drejtësinë tranzicionale. Ky diskurs kuptohet si një proces që kërkon të vë në vend mekanizma që merren me padrejtësitë e të kaluarës, ndihmojnë shërimin dhe parandalojnë më tutje mizori të ngjashme. Janë krijuar struktura formale që kanë qëllim adresimin e këtyre çështjeve. Gjykimet dhe thënia e së vërtetës

¹⁰ Baraslou, Judy and Baxter, Victoria. (2007). *The Urge to Remember: The Role of Memorials in Social Reconstruction and Transitional Justice* (Nxitja për kujtim: Roli i memorialëve në rindërtim social dhe Drejtësi Tranzicionale).

¹¹ Naidu Ereshnee, *The Ties that Bind: Strengthening the Link Between Memorialisation and Transitional Justice* (Lidhjet që lidhin: Forcimi i lidhjes midis Memorializimit dhe Drejtësisë Tranzicionale). CSV Centre for the Study of Violence and Reconciliation, 2006, f2.

¹² Komisioni Kombëtar Kilean i së vërtetës dhe pajtimi, Komisioni i Afrokano-Jugor i së vërtetës dhe pajtimin dhe Komisioni i Guatemalës për të vërtetën kanë bërë rekomandime të cilat theksojnë nevojën për memorializimin e mizorive të kaluara.

¹³ Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, 'Memorialisation and Democracy: State Policy and Civic Action' (Memorializimi dhe demokracia: Politika shtetërore dhe aktivizmi qytetar), *International Centre for Transitional Justice*, 2007, f21.

mund të jenë çliruese por gjithashtu mund të nxisin tensione, pasi theksojnë ndarjet në mes kryesit të kimit dhe viktimës. Memorializimi, sidoqoftë, ofron një mundësi qasjeje më gjithëpërfshirëse, shumëgjyreshe dhe qasje me orientim social për tu ballafaquar me të kaluarën. I trajtuar me ndjeshmëri, memorializimi mund të asistoj në realizimin e disa qëllimeve të drejtësisë tranzicionale. Mund të kontribuojë në zbulimin e së vërtetës; mund të veprojë si një formë e reparacionit simbolik për viktimat e konfliktit, dhe mund të shërbejë si përkujtues dhe mjet edukativ për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Mund të promovoj retorikën e mos përsëritjes së dhunës. Ndikimi i memorialëve në formësimin e kujtimeve të ardhshme, miteve dhe qëndrimeve, nuk duhet nënvlerësuar; prandaj strategjitë e kujtesës duhet të njihen si pjesë përbërëse e proceseve të përgjithshme të ndërtimit të demokracisë. Duhet të jetë përgjegjësi e shtetit që të sigurojë se politika mbi kujtesën është e përfshirë në një proces më të gjerë të drejtësisë tranzicionale. Kjo megjithatë është një përgjegjësi që duhet të mbështetet nga historianët, organizatat e shoqërisë civile, kuratorët e muzeve, akademikët, si dhe të tjerë që kanë aftësinë për të ndihmuar zhvillimin e kushteve ku inkurajohet dialogu historik. Dështimi për të shfrytëzuar anët e forta të memorializimit konstruktiv do të ishte një mundësi e humbur për të rritur ndërtimin e paqes në shoqëritë pas-konfliktit.¹⁴

Projektet e Memorializimit duhet të sugjerojnë se kujtesa nuk siguron një rrugë të drejtpërdrejtë në të kaluarën; por ajo është një vizion i së kaluarës që lëviz me rrjedhshmëri, sipas të tashmes. Kjo natyrë iluzive e kujtimit, ndryshe nga rrëfimet e historisë tradicionale, lë hapësirë për reflektim dhe interpretim. Memorializimi, si një kornizë për aktin e të përkujtuarit, duhet të reflektojë këtë natyrë ngjyruese të interpretimit të së kaluarës. Vërtetë, kuptimi më i plotë i përkohshmërisë së kujtesës ka filluar të ndryshojë estetikën përkujtimore. Memorialët janë duke u bërë më abstrakte për të inkurajuar reflektimin. Memoriali i famshëm i Holokaustit në Berlin, i përbërë nga një seri blloqesh me madhësi të ndryshme betoni, kishte për qëllim nxitjen e ndjenjës së pasigurisë dhe shqetësimit, në mënyrë që të stimulojë “introspektion të kthjellët”.¹⁵ Dizajni abstrakt synon të nxisë një proces të vazhdueshëm të reflektimit kritik që vepron si përkujtues se e kaluara nuk duhet t’i dorëzohet historisë, por më tepër ajo duhet të mbetet brenda ndërgjegjës publike.

Që memorializimi të kontribuoj në mënyrë efektive për qëllimet e drejtësisë tranzicionale, duhet të jetë një proces i matur që angazhon një gamë të plotë të palëve të interesit, duke përfshirë të mbijetuarit e konfliktit. “Procesi është pjesa më e rëndësishme” dhe memorialet më të suksesshme janë ato që promovojnë ‘performancë dinamike të angazhimit qytetar apo demokracisë’¹⁶. Për më tepër, memorialet që nuk arrijnë të përfshijnë çdo lloj të edukimit në lidhje me atë që ato përfaqësojnë, rrezikojnë të duken ‘peng i së kaluarës’. Me fjalë të tjera, dështojnë të ofrojnë diçka konstruktive prej të cilës gjeneratat e ardhshme mund të mësojnë. Thjeshtë ‘ruajtja e vuajtjeve të kaluara vetëm në kujtesë ka gjasa të verboj dikë drejt padrejtësive të reja dhe të kontribuojë në një obsesion të ngushtë me vetveten apo një grup të ngushtë, (më shumë se) të luajë rol sensibilizues apo të nxisë imagjinatën

¹⁴ Naidu Ereshnee, 2006, f2.

¹⁵ Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, 2007, f18.

¹⁶ Liz Ševenko, cited in Judy Barsalou and Victoria Baxter, *The Urge to Remember: The Role of Memorials in Social Reconstruction and Transitional Justice* (Nxitja për kujtim: Roli i memorialëve në rindërtim social dhe Drejtësi Tranzicionale), in *Stabilization and Reconstruction*, No. 5, 2007, f14.

morale¹⁷. Vërtetë, Memoriali i Holokaustit në Berlin fillimisht mori kritika për faktin se planet origjinale për lokacionin nuk përfshinin një qendër informacioni. Disa kishin frikë se pa informacionin për të kontekstualizuar memorialin, kuptimi ishte në rrezik të harrohej. Është argumentuar se pa një komponent edukative nga i cili brezat e ardhshëm do të mund të përfitojnë, memoriali kryesisht ka ekzistuar si një mjet që Gjermania ta shuaj fajin e vet, duke lënë disi çështjen të pushojë. Shtimi i qendrës së informimit ndihmon në balancimin e këtij argumenti.¹⁸ Memorializimi që inkurajon një eksplorim të kujtimeve të kontestuara dhe nxit debatin, dialogun dhe të menduarit kritik, në majat e demokracisë, ka më shumë gjasa për të ndihmuar mbështetjen e qëllimeve të drejtësisë tranzicionale.

4. METODOLOGJIA

Vëmendje e vogël i është kushtuar çështjes së memorializimit në Kosovë që nga lufta e viteve 1998-99. Prandaj, ka mungesë të literaturës në këtë temë. Rrjedhimisht, ky raport nuk mbështetet vetëm në analizimin e literaturës por jep të dhëna të mëtejshme të mbledhura përmes intervistave gjysmë të strukturuar. Është e rëndësishme që ta kemi parasysh që memorializimi në relacion me drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën në Kosovë, mbetet një fushë e studimit shumë e re dhe e pashkelur. Megjithatë ka pyetje të rëndësishme që ne mund të fillojmë t'i adresojmë dhe ky punim ka për qëllim të ndihmojë në vënien e themeleve për diskutim të mëtejshëm dhe praktika të ardhshme mbi çështjen e memorializimit në Kosovë.

Intervistat gjysmë të strukturuar janë zhvilluar me individë me njohuri në temën e memorialeve dhe ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë. Të intervistuarit që kontribuan në këtë hulumtim ishin nga Instituti i Kërkimeve për Krime të Luftës, Instituti Kombëtar Demokratik, UNDP Kosovë, forumZFD, një profesor nga Departamenti i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës, një profesor nga Programi i Studimeve Gjinore në Universitetin e Prishtinës dhe një profesor nga Programi i Studimeve Gjinore, gjithashtu i angazhuar me *Alter Habitus*.

Intervistat kishin për qëllim të ndihmojnë në kuptimin e qasjes aktuale ndaj memorializimit në Kosovë dhe të mbledhin mendime personale dhe perspektiva nga të intervistuarit përkatës. Të intervistuarit kanë ofruar perspektiva lidhur me problemet aktuale dhe gjithashtu kanë përfshirë sugjerime lidhur me mënyrën si të ecet përpara me këtë çështje në një mënyrë konstruktive. Struktura e pyetjeve, në mes tjerash ka përfshirë: "Cilat janë shqetësimet kryesore në lidhje me çështjen e memorializimit në Kosovë?"; "Cilët faktorë merren parasysh aktualisht në zbatimin e memorialeve dhe kush është konsultuar?"; "A mendoni se memorialet kanë rol në mbështetjen e iniciativave që synojnë të vijnë në pajtim me të kaluarën në Kosovë?"; "A mendoni se memorializimi mund të përfshihet në një kornizë më të gjerë të drejtësisë tranzicionale?".

¹⁷ J. Allen, cited in Alexandra Barahona de Brito, Paloma Aguilar, Carmen Gonzalez-Enriquez (eds.), 'The Politics of Memory: Transitional Justice in Democratizing societies,' (Politikat e kujtesës: Drejtësia Tranzicionale në shoqëritë nw demokrtizim) 2001, f38-9.

¹⁸ Sharon Chin, Fabian Franke, Sheri Halpern, 'A Self-Serving Admission of Guilt: An Examination of the Intentions and Effects of Germany's Memorial to the Murdered Jews of Europe' (Vetë pranimiti i fajit: Një shqyrtim nga qëllimet dhe efektet e Memorialit të Gjermanisë ndaj hebrenjve të vrarë të Evropës), Humanity in Action, <http://www.humanityinaction.org/knowledgebase/225-a-self-serving-admission-of-guilt-an-examination-of-the-intentions-and-effects-of-germany-s-memorial-to-the-murdered-jews-of-europe>, 2011.

5. POLITIKAT ZYRTARE TË MEMORIALIZIMIT NË KOSOVË

Në Kosovë është vetëm një memorial i mbrojtur me ligj. Projektligji për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës ofron mbikëqyrjen ligjore të Kompleksit Memorial Adem Jashari në Prekaz. Lokacioni shënon përkujtimin e masakrës ndaj Adem Jasharit, themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) dhe pesëdhjetë e gjashtë anëtarëve të familjes së gjerë, të cilët u vranë në Mars të vitit 1998.

Qeveria mori vendim për të shënuar 5-8 Marsin si përvjetorin zyrtar komemorativ për të kujtuar familjen Jashari dhe forcat e UÇK-së. Kjo tani është ngjarja më e madhe komemorative në vend. Dita Nationale e Personave të Pagjetur në Kosovë, 27 Prilli, shënon kujtimin e masakrës së Mejës. Ndërsa 5 Maji mbahet mend si Dita e Dëshmorëve, këtu përsëri fokus është kryesisht kujtimi i luftëtarëve të rënë të UÇK-së. Ka gjithashtu disa ditë të lokalizuara të kujtimit që përkujtojnë vende të ndryshme të masakrave (Intervista 1).

6. ANALIZA

6.1 KUJTESA NUK ËSHTË E INSTITUCIONALIZUAR

Të gjithë të intervistuarit ishin kritikues për mungesën e një qasjeje intelektuale ndaj memorializimit në Kosovë. Ka disa ditë përkujtimore vjetore por nuk ka ditë kombëtare të përkujtimit për të gjitha viktimat e konfliktit. Përveç legjislacionit lidhur me Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz, asnjë memorial tjetër nuk është ndërtuar brenda një kuadri ligjor. Si pasojë, për monumentet që janë shfaqur, nuk kërkohet që të veprojnë në përputhje me standardet e caktuara, as nuk ka një përpjekje të ndërgjegjshme për të siguruar që ato janë të mbrojtura dhe të ruajtura.

Ishte e dukshme në intervista se ka shumë paqartësi në lidhje me atë se kush është përgjegjës për ndërtimin e memorialeve. Është e paqartë se kush kujdeset për to, ose më saktësisht se si këto janë të financuara. Shumica dërrmuese e memorialeve, veçanërisht ato të ndërtuara menjëherë pas luftës, janë nisma private, të ndërmarra nga familjet e viktimave ose nga Shoqata e Veteranëve të Luftës. Në disa raste, iniciativat

“Nuk ekziston askush që të thotë, “Jo, nuk mund ta ndërtosh këtë memorial këtu”. Intervista 4

“Është vetëm një pjesë e legjislacionit që ofron mbrojtje të memorialeve. Ne duhet të mendojmë rreth asaj se si kjo i bën të ndjehen familjet e viktimave të tjera. Një individ kujtohet dhe lokacioni i tij mbrohet, ndërkaq për të tjerët nuk shfaqet asnjë vlerësim. Ata nuk e dijnë as se ku janë anëtarët e familjeve të tyre.”
Intervista 4

janë implementuar nga Komunitat. Studimi i *Alter Habitus* 2011 nuk ishte në gjendje të identifikojë qartë se cilat organizata brenda komunave ishin përgjegjëse për ndërtimin e memorialeve dhe nëse ekziston një kornizë e përbashkët në të gjitha komunitet.

Nuk ka kufizime të planifikimit në lokacione, kështu që memorialet ndërtohen pak a shumë në çdo vend, në çdo kohë, nga kushdo. Kjo është problematike, dhe mund të lindin mosmarrëveshje në qoftë se memorialet bëhen pengesa për ndërtime të mëtejshme. Deri tani, nuk janë mbledhur të dhëna empirike dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me memorialet nëpër Kosovë (Intervista 6).

Hutimi në lidhje me memorialet është ilustruar në Memorialin në Marinë të Skenderajit, një memorial për luftëtarët e UÇK-së. Lokacioni është financuar nga para ndërkombëtare dhe është ndërtuar në vitin 2005, por pas neglizhencës nga ana e autoriteteve të Kosovës është marrë vendim nga donatorët për të mbyllur vendin në vitin 2014. Duket se ka pasur mosmarrëveshje brenda parlamentit mbi atë se cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e memorialeve.¹⁹

Një i intervistuar theksoi një pasojë të mëtejshme të problemit të mungesës së legjislacionit të qeverisë në lidhje me zbatimin dhe mbrojtjen e memorialeve: Shoqata e Gazetarëve ka vendosur një pllakë në Veri të Kosovës për të përkujtuar një gazetar serb i cili është zhdukur gjatë luftës. “Çdo vit kjo largohet, dhe çdo vit asociacioni mundohet ta rivendosë. Ka thirrje për mbrojtje nga qeveria për çështjet si kjo, por deri tani nuk ka pasur asgjë” (Intervista 4). Për më tepër, i intervistuari i njejtë beson se çdo OJQ që ka tentuar të zbatojë një iniciativë të përbashkët që përfaqëson të gjitha etnitë, nuk ka marrë mbështetjen e qeverisë. Ishte një iniciativë e të rinjve që u përpoq për të rritur ndërgjegjësimin për të gjithë personat e zhdukur, por emrat e joshqiptarëve u hoqën dhe rrjedhimisht memoriali është shpërbërë.²⁰

6.2 QASJA ETNO-NATIONALISTE

Kosova mbetet një shoqëri e ndarë, kështu që memorializimi karakterizohet me mënyrën etno-nacionaliste të relfektimit të së kaluarës. Janë një numër i monumenteve që nderojnë kujtimin e civilëve të vrarë në masakra, por siç është rasti në të gjithë rajonin e Ballkanit, të tjerat janë shpesh përfaqësuese të identitetit kombëtar, tregimeve legjendare të fitores, dhe virtyteve të mëdha të martirëve individualë. Ky verzion i politikave të kujtesës rrezikon “mbajtjen gjallë të emocioneve përjashtuese dhe përçarëse nga vitet e luftës”.²¹

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, memorialet janë larguar nëqoftëse nuk janë përshtatur me tregimin e preferuar politik. Shumë shtete ish-komuniste në të gjithë bllokun ish-sovjetik e kanë parë shkatërrimin e elementeve të peisazhit ekzistues të kujtesës së tyre. Për shembull në Gjermaninë Lindore, është bërë largim shumë i shpejtë i

“Ka një tendencë për të prerë të gjitha lidhjet me të kaluarën dhe për të krijuar një perceptim të ri për vetën. Kjo është jashtëzakonisht e rrezikshme.” Intervista 2

¹⁹ Edona Peci, Kosovo MPs Outrages as War Memorial Closes, *Balkan Transitional Justice*, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-mps-slam-government-on-memorial-neglect>, 2014.

²⁰ Anna Di Lellio and Caitlin McCurn, ‘Engineering Grassroots Transitional Justice in the Balkans: The Case of Kosovo (Ndërtimi i themelit të Drejtësisë Tranzicionale në Ballkan: Rasti i Kosovës)’, *East European Politics and Societies*, 2(1), 2012, f11.

²¹ Lutz Schrader, ‘Monuments and politics of identity in the Western Balkans’ (Monumentet dhe politika e identitetit në Ballkanin Perëndimor), *Made in KS: Periodical dedicated to learning from the past in Kosovo*, 11, 2012, f6.

monumenteve të stilit Leninist, pas rënies së Murit të Berlinit. Ngjashëm, pas luftës në Kosovë, shumë monumente jugosllave janë larguar pa ndonjë analizë. Të intervistuarit kanë komentuar mbi faktin se ajo është sikur një periudhë e fshirë e historisë. Një i intervistuar shpjegon se si "Viti 1999 në mënyrë efektive u bë "viti zero". "E kaluara është fshirë dhe çdo gjë ka filluar përsëri përmes një procesi të ndërtimit të shtetit" (Intervista 2). Siç u përmend më parë, manipulimi i së kaluarës në mënyrë që të përshtatet me rendin aktual politik paraqet një përshkrim të ngushtë dhe të pasaktë të historisë.

Narrativi që e rrethon Adem Jasharin është narrativ dominant i shtet-ndërtimit në Kosovë. Jashari përfaqëson rezistencën dhe për këtë arsye vepron si një kujtesë e detyrimit për të mos harruar ata që ndihmuan për të çliruar kombin. Në vend që të mbështet një narrativ i viktimizimit tregimi u jep autoritet shqiptarëve dhe përfaqëson angazhimin për pavarësi.²² *Alter Habitus* nga fokus grupi në Gjilan, ka nxjerrur në pah, që memoriali i Adem Jasharit është i rëndësishëm, sepse paraqet lirinë dhe sakrificën e vetë personale që nuk duhet të harrohet. Njëri nga të intervistuarit thekson që edhe pse ky është tregimi dominant, mund të ketë interpretime kontradiktore brenda të njejtës bashkësi etnike në lidhje me atë se si Jashari mbahet mend.²³ Ky i intervistuar shpreh mendimin se 'është e vështirë për të sfiduar tregimin e Jasharit si një hero, qoftë nëse je shqiptar apo serb, sepse ju do të shiheni si një tradhtar' (Intervista 4). Ky përfaqësim dominant, nga lart-poshtë, i së kaluarës lejon hapësirë të vogël për një llojllojshmëri të rrëfimeve brenda peizazhit aktual të kujtesës së Kosovës.

“Shqiponja është kudo. Poashtu mund të shihni armë kudo, dhe duke parë armë kudo nuk është një mesazh i mirë për gjeneratat e ardhshme.” Intervista 5

6.3 QASJA ESTETIKE SOCIO-REALISTE DHE GJINORE

“Ata nuk përkujdesen shumë gjatë ndërtimit të memorialeve, nuk mendohet shumë për to.” Intervista 5

Estetiki është shumica e memorialeve pasqyrojnë dizajnin socio-realist nga epoka e komunizmit. Shumica e të intervistuarve pajtohen që ato nuk kanë ndonjë vlerë artistike. Estetika socio-realiste është jashtë mode dhe është në kontradiktë me qëllimin kosovar të zhvillimit të të marëdhënies të forta euro-atlantike.²⁴ Në përputhje me qëllimin e ndërtimit të kombit, shumë paraqesin luftëtarë të fortë dhe simbole të luftës. Shumica e të intervistuarve kanë komentuar në faktin se stili aktual i memorialeve në Kosovë është agresiv, mashkullor dhe kërcënues. Një i intervistuar ndjenë se është "frika se lufta nuk ka përfunduar që i shtyn njerëzit të paraqesin një komunitet të luftëtarëve - si të fortë dhe sa më

²² Anna Di Lellio and Stephanie Schwandner-Sievers, 'The Legendary Commander: The Construction of an Albanian Master Narrative in Post-war Kosovo' *Kosovo* (Komandanti Legjendar: ndërtimi i një master-narracioni shqiptar në Kosovën e pasluftës), *Nations and Nationalism* 12(3), 2006, f526.

²³ Anna Di Lellio and Stephanie Schwandner-Sievers, 2006, gjithashtu i referohen kësaj.

²⁴ Valur Ingimundarson, 'The Politics of Memory and the Reconstruction of Albanian National Identity in Post-war Kosovo' *Politika e kujtesës dhe rindërtimi i identitetit kombëtar shqiptar në Kosovën e pasluftës*, *History and Memory*, 19 (1), 2007 f95.

mashkullor që të jetë e mundur". Dështimi për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse të kaluarën "e mbanë të gjallë idenë e nevojës së vazhdueshme për të luftuar për liri "(Intervista 2). Ky nocion është përmbledhur ndoshta në shumë monumente të Kosovës. Ky është mesazh shqetësues dhe joinformativ për tu bazuar gjeneratat e tashme dhe të ardhme.

Shumë nga memorialet e stilit socio-realist nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht identitetin e vërtetë të personit ose personave që pretendojnë që përfaqësojnë (Intervista 2/5). Një i intervistuar dha një shembull të këtyre memorialeve duke thënë se në Kosovë memorialet shërbejnë për të mbështetur mitet: "Monumenti i Agim Ramadanit paraqet një figurë të fortë të tipit luftëtar, kur në fakt ai mbahet mend si një njeri i qetë i cili lexonte shumë. Të qenurit luftëtar nuk ishte identiteti i tij por ky është rrëfimi që ua tregojmë fëmijëve tanë" (Intervista 2). Këto memoriale injorojnë atë se çfarë është të jeshë një burrë i zakonshëm apo grua e zakonshme si në kohërat e konfliktit ashtu dhe në rimëkëmbjen pas konfliktit.

"Peizazhi i tanishëm i kujtesës nënkupton që shqiptarët gjuanin serbët, ose masakroheshin nga ata. Ka një tendencë për të ridizajnuar kujtesën që i pasqyron shqiptarët si luftëtarë dhe asgjë tjetër."
Intervista 2

Vërtetë, të gjithë të intervistuarit kanë theksuar nevojën për vëmendje më të madhe në rolin e grave në përpjekjet e memorializimit. Peizazhi i tanishëm i kujtesës është në përputhje me normat patriarkale dhe kështu paraqet pengesa të mëtejshme për gratë që kërkojnë të sfidojnë status quo-në dominuese të meshkujve²⁵. Burrat dhe gratë në mënyrë të pashmangshme kanë pasur role të ndryshme, por shumë të rëndësishme gjatë konfliktit. Për shembull, roli qendror i grave në lëvizjen e rezistencës së fshehtë *Illegalja* gjatë viteve 1990 ishte një kontribut thelbësor në çlirimin kombëtar dhe shtet-ndërtimin. Megjithatë, kjo lëvizje nuk është e dukshme sot në kujtesën kolektive të kosovarëve. Është e qartë që "pas

luftës beteja e njohjes u fitua nga meshkujt."²⁶ Me fjalë të tjera, "gratë nuk kanë vend të rëndësishëm në memorialet zyrtare dhe private që i dedikohen dëshmorëve të luftës."²⁷ Projektet aktuale të memorializimit në Kosovë në mënyrë të argumentueshme ndihmojnë për të përforcuar idenë që shoqëria është e ndërtuar nga burrat dhe gratë janë pasive dhe u mungon veprimi.

Kohët e fundit ka pasur qasje tentative për trajtimin e çështjes së dhunës seksuale gjatë luftës. Memoriali *Heroinat* është inauguruar më 12 Qershor 2015 në Prishtinë, dedikuar viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit 1998-99. Sidoqoftë, shumica e të intervistuarve ishin kritik ndaj këtij memoriali. Pakënaqësia është

"T'ua mohosh viktimave pronësinë vendore mbi këtë lloj të memorialit është kolonizim i përvojës së tyre të dhimbjes."Intervista 6

²⁵ Elife Krasniqi, 'Memorials in Kosovo Today' (Memorialet sot në Kosovë), *Made in KS: Periodical dedicated to learning from the past in Kosovo*, 6, 2011, f5.

²⁶ Elife Krasniqi, 'Illegalja: Women in the Albanian Underground Resistant Movement in Kosovo' *Illegalja: Gratë në lëvizjen e rezistencës së fshehtë shqiptare në Kosovë*, *ProFemina*, Special Edition 2, Summer/Fall, 2011, f14.

²⁷ Anna Di Lellio and Stephanie Schwandner-Sievers, 'The Legendary Commander: The Construction of an Albanian Master Narrative in Post-war Kosovo' *Kosovo* (Komandanti Legjendar: ndërtimi i një master-narracioni shqiptar në Kosovën e pasluftës), *Nations and Nationalism* 12(3), 2006, f522.

shprehur mbi faktin që nuk ka pasur proces më të gjerë të diskutimit shoqëror, ose një përpjekje për të angazhuar dhe konsultuar ata që janë prekur nga ky problem. Nuk ka asnjë përpjekje për të siguruar pronësinë vendore mbi këtë memorial dhe kështu mund të interpretohet si një mënyrë e shkujdesur e adresimit në emër të viktimave të dhunës seksuale (Intervista 6/7). Kjo sigurisht është një çështje jashtëzakonisht komplekse dhe e ndjeshme, pasi që dhuna seksuale mbetet një temë shumë e stigmatizuar. Qëndrimet shoqërore ndaj viktimave të dhunës seksuale vazhdojnë ta bëjnë tepër të vështirë që njerëzit haptazi të kërkojnë mbështetje apo çfarëdo lloj konsultimi.

Shumica e të intervistuarve janë pajtuar se ndërtimi i *Heroinat* ishte shumë qartë një gjest politik sa ‘për sy e faqe’ më tepër se sa një ofertë e mbështetjes së vërtetë për viktimat e dhunës seksuale. Memoriali është i pakuptimtë pa një diskutim të vërtetë në lidhje me këtë çështje. Nuk ka pasur asnjë diskutim as në Beograd në lidhje me dhunën seksuale gjatë luftës. Pa debat rreth çështjes që memoriali ka për qëllim të përfaqësojë, mund të shihet pak a shumë si një njohje e rreme nga ana e qeverisë për krimet e kryera dhe dhimbjet e vuajtura.

6.4 QASJA INDIVIDUALISTE

Një shqetësim tjetër i ngritur nga të intervistuarit është se pasi që shumë monumente janë iniciativa private, mesazhi që ata përfaqësojnë është individualist. Ka pak për të përfaqësuar kujtesën kolektive të luftës. Peizazhi i tanishëm i kujtesës paraqet një imazh të ngushtë të Kosovës. Paraqet një histori të luftimit, duke injoruar një dekadë të rezistencës paqësore. "Kujtimet janë duke u shuar, lënë pas dore, dhe harruar"

(Intervista 3). Një i intervistuar i referohet Shkollës Shtëpi për shembull si gjerësisht të harruar, dhe siç është përmendur më parë, njëjtë është edhe me protestat e grave që kanë ndodhur gjatë viteve të 90-ta.²⁸ Këto aspekte të historisë së Kosovës nuk janë pjesë e kujtesës kolektive por ato kanë potencialin për të siguruar një mesazh konstruktiv, informativ dhe edukativ të luftës të njeriut dhe jo-dhunës në brezat e ardhshëm. Një numër i të intervistuarve kanë sugjeruar se duhet të ketë një memorial

“Disa janë me të vërtetë të çuditshme. Ato nuk japin mesazh të asaj që ka ndodhur me të vërtetë. Nuk ka histori sociale. Nuk ka përfaqësim fizik të kujtesës kolektive të luftës.”Intervista 2

reflektues të **përpjekjes civile** dhjetëvjeçare kundër shtypjes serbe. “Nuk është vetëm Presidenti Ibrahim Rugova që duhet të përkujtohet, por gjithashtu dy milion kosovarë që kanë jetuar gjatë kësaj periudhe.” (Intervista 2). Një i intervistuar ishte i mendimit se pas luftës kujtesa ishte i ndarë në mes të "krahut të paqes" dhe "krahut të luftës". PDK-ja, si partia në pushtet menjëherë pas luftës, "kapitalizoi kujtesën e UÇK-së dhe është punuar shumë për të diskredituar rezistencën paqësore të viteve 1990 në favor të kujtesës së UÇK-së" (Intervista 5). Një tjetër i intervistuar, foli ngjashëm, duke thënë se “makro-narrativi është

“Ka vullnet për të turpëruar Serbinë me tepër se sa dëshirë për të përkujtuar përvojën e kosovarëve.” Intervista 2

²⁸ Elife Krasniqi, ‘Illegalja: Women in the Albanian Underground Resistant Movement in Kosovo’ (Illegalja: Gratë në lëvizjen e rezistencës së fshehtë shqiptare në Kosovë), *ProFemina*, Special Edition 2, Summer/Fall, 2011, f4.

ai i luftës së armatosur dhe UÇK-së, mikro-historitë e përpjekjeve të njerëzve të zakonshëm në jetën e përditshme mungojnë. Këto çështje nuk janë diskutuar dhe nuk janë prezente në memoriale. Edhe nëse janë diskutuar ndonjëherë ato janë marginalizuar” (Intervista 6).

Dështimi për të shfrytëzuar kujtesën kolektive të luftës – kujtimin e rezistencës paqësore dhe përvojën e vuajtjes së përbashkët, jo vetëm që nuk arrinë të mbështesë zhvillimin e marrëdhënieve përtej grupeve etnike, por gjithashtu mund të përkeqësoj ndarjet brenda të njëjtit komunitet etnik. Prioritet i është dhënë dëshmorëve dhe anëtarëve të UÇK-së, para civilëve të zakonshëm. Për më tepër, ashtu si një nga të intervistuarit është shprehur, duke dështuar në ofrimin e një gjesti të përkujtimit që është përfaqësues i shoqërisë më të gjerë, nuk bëhet asgjë për të zbutur konkurrencën potenciale të viktimizimit në mes të anëtarëve të UÇK-së dhe civilëve të zakonshëm, si dhe konkurrencën mes civilëve të zakonshëm të vrarë si pasojë e bombardimeve të NATO-s, dhe atyre që u vranë nga UÇK-ja apo ushtarët serb në terren (Intervista 4).

6.5 NJË LIGJ I RI

Ekziston një nevojë e madhe për një ligj të ri që monitoron dhe rregullon ndërtimin e memorialeve. Duhet të bëhet e qartë se kush është përgjegjës për mirëmbajtjen e memorialeve. Legjislacioni duhet të përcaktojë kërkesat dhe standardet në bazë të të cilave duhet të jenë memorialet.²⁹

“Kriteri duhet të përcaktojë atë se kush duhet të jetë përgjegjës për të ndërtuar memorial dhe mesazhin shoqëror që do të promovohet.” Intervista 1

Një numër i të intervistuarve argumentojnë që pas luftës ishte një ndjesi euforie që çoi në ndërtimin e memorialeve. Nuk i është kushtuar kohë për të zhvilluar një qasje më të përmbajtur që do të mund të jepte rezultate më të mira në lidhje me politikën mbi memorializimin. Nuk kishte asnjë diskutim në lidhje me krijimin e një kornize për memorializimin që të mishërojë një “qasje më moderne, universale, apo më humane” (Intervista 5). Aktualisht gjuha e përdorur për të përshkruar arsyen e një memoriali shpesh është provokuese. Memorialet duhet t’i shmangen gjuhës së urrejtjes (Intervista 1). Korniza ligjore për memorialet duhet të promovojë gjithëpërfshirjen duke shmangur simbolet e përkatësisë etnike dhe të demonstrojë një kuptim të vuajtjes së përbashkët (Intervista 6/7). Memorialet gjithnjë e më shumë janë njohur si një formë e

²⁹Politika zyrtare e memorializimit në Cape Town, Afrikë e Jugut, në mënyrë të qartë jep një numër të rezultateve të dëshiruara të cilat memorialët duhet t’i përmbahet. Për shembull nenin 3.2.4 thotë angazhimin e Qytetit për të “ruajtur kundër përdorimit të memorializimit për qëllime sektare apo përfitime politike të partive”. Neni 3.2.7 theksin angazhimin e Qytetit për “nxitjen e partneriteteve në të gjithë departamentet e qytetit për të siguruar një qasje të integruar organizative në ndërtimin e memorialëve të reja”. Politika Memorializimit në Cape Town është ndërtuar së bashku me një plan më të gjerë të zhvillimit. Një prioritet i planit të zhvillimit është krijimi i një qyteti gjithëpërfshirës. Neni 4.1.4 i Politikës në Memorializimit thekson se “një qytet gjithëpërfshirës është një, ku të gjithë kanë një pjesë në të ardhmen dhe gëzojnë një ndjenjë të përkatësisë. Memorializimi është një mënyrë për të nxitur kuptim më të madh dhe për të ndërtuar kohezionin brenda komuniteteve”. Një dokument i politikave të tilla si kjo jep një shembull të një kornize ligjore që tregon një angazhim për respektimin e parimeve demokratike nëpërmjet memorializimit.

reperacionit simbolik.³⁰ Ato kanë më shumë gjasa për të përmbushur këtë rol nëse përfaqësojnë shoqëri më të gjerë se sa të qënit përfaqësues të individëve të veçantë. Mirëpo, nuk duhet të kuptohen si e vetmja formë e reperacionit. Kjo minon potencialin e tyre për të vepruar si hapësira për angazhim demokratik dhe edukativ. Ligj i ri duhet të kërkojë që të mbështesë kapacitetet edukative të memorialeve.

6.6 NJË PRAKTIKË E RE

Në rastet kur qeveria ka ndërmarrë nismën për të ndërtuar një memorial në lidhje me viktimat, për shembull *Heroinat*, integriteti i projektit nuk është domosdoshmërisht i besueshëm. Kjo është për shkak të mungesës së diskutimit politik apo shoqëror rreth çështjeve më të gjëra, si dhe mungesës së angazhimit shoqëror në procesin e ndërtimit të memorialit (Intervista 4/6). Si rezultat i manipulimit të përbashkët të së kaluarës dhe politizimit e kujtesës, iniciativat e qeverisë për kujtesën ka gjasa që do të trajtohen me dyshim.³¹

“Duhet punë për të kthyer diçka në art publik, që është tërheqës, që nuk është i mbyllur, që mund të ftojë perspektiva të shumëta, që nuk parapërcakton kategori.”
Intervista 7

Ka nevojë të fitohet një praktikë e re që përfshinë angazhimin e një sërë aktorësh për të zbutur këto dyshime. Në linjë me standardet ndërkombëtare për projekte të suksesshme të memorializimit, memorialet në Kosovë duhet të veprojnë si një ‘proces’ që promovon dialogun historik, nëse duan të bëjnë më shumë se sa të diktojnë një verzion të veçantë të së kaluarës. Aktorët kryesorë për t’u përfshirë në një proces të tillë janë; historianët, OJQ-të, grupet e komunitetit, planifikuesit urban, artistët, grupet rinore dhe shoqatat e viktimave. Një raport i QNDT-së paralajmëron se qeveritë mund të “kryejnë një gabim skandaloz, duke mos i përfshirë viktimat në krijimin dhe programimin e vendit (të memorialit)”.³² Përfshirja e të mbijetuarve të dhunës në projektet e memorialeve ndihmon në transformimin e tyre nga viktima në agjentë aktiv për ndryshim, të cilët mund të marrin pjesë në shpërndarjen e drejtësisë.

Argjentina jep shembuj të mirë të projekteve të kujtesës që involvojnë bashkëpunim të ngushtë mes agjencioneve të qeverisë dhe shoqërisë civile. Për shembull në Buenos Aires ‘Walk of Human Rights’ është krijuar brenda Parkut Indo-Amerikan të qytetit. Kjo është një hapësirë e reflektimit dedikuar për 30.000 viktimat të cilët u zhdukën gjatë diktaturës në Argjentinë. Agjencitë qeveritare të turizmit, zhvillimit dhe ambientit kanë punuar së bashku me OJQ-të, me grupet ambientaliste dhe me grupet për të drejtat e njeriut, gjithashtu edhe me banorë lokal, ku të gjithë kanë marrë pjesë në diskutim në lidhje me konceptin dhe dizajnin e projektit.³³ Është thelbësore që ndërtimi i një memoriali të shoqërohet nga

³⁰ Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, ‘Memorialisation and Democracy: State Policy and Civic Action’ (Memorializimi dhe demokracia: Politika shtetërore dhe aktivizmi qytetar), *International Centre for Transitional Justice*, 2007, f21.

³¹ Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, 2007, f21.

³² Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, 2007, f30.

³³ Memoria Abierta, <http://www.memoriaabierta.org.ar>, 2015; Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, 2007, f25.

një proces më i gjerë i dialogut, që inkurajon një shumësi të perspektivave në mënyrë që t'i mbështesë parimet e demokracisë.

Pas fazës së ndërtimit, gjithashtu duhet diskutuar këndvështrimi përmes të cilit memorialet shihen dhe kuptohen. Diskutimi dhe procesi rreth memorialeve duhet të njihet dhe t'i dihet vlera që është po aq e rëndësishme sa produkti final.³⁴ Siç kanë pohuar të intervistuarit tanë, përfshirja e një elementi edukativ në memoriale, si dhe krijimi i lidhjeve në mes vendeve të memorialeve dhe programeve të arsimimit formal dhe joformal është kryesor në aspektin e integritetit të memorialeve në një proces më të gjerë të adresimit të së kaluarës (Intervista 6/7).

“Memorialet duhet të analizohen, debatohen dhe të diskutohen, jo vetëm thjeshtë ta zënë një hapësirë publike.”

Intervista 3

Të intervistuarit, gjithashtu kanë shprehur nevojën për një dokumentim të të gjitha memorialeve në Kosovë, duke përfshirë një fotografi, përshkrim dhe informata se kur është ndërtuar memoriali, kush e ka ndërtuar dhe kush e ka financuar. Kjo mund të ndihmojë për të hapur diskutimin dhe për të siguruar informacion për atë se çfarë domethënie kanë këto memoriale për njerëzit, si kuptohen, dhe se si i bëjnë njerëzit të ndjehen.

Një çështje tjetër që duhet theksuar sa i përket zhvillimit të një procesi të ri është që projektet e ardhshme për memoriale duhet të paraqiten si gara ndërkombëtare. Aktorët kombëtar dhe ndërkombëtar duhet të inkurajohen për të paraqitur ide. Gara inkurajon mendime kreative dhe kjo do të ndihmojë që të qëndrohet larg nga estetika e tanishme socio-realiste.

6.7 NJË FILOZOFI E RE

Është e nevojshme të zhvillohet një filozofi e re përtej konceptit të memorializimit. Ekziston nevoja që të rritet njohja e rolit të memorializimit në ballafaqimin me të kaluarën. Vendimtare për këtë është zhvillimi i një kuptimi në rritje të kapacitetit edukativ të memorialeve. Për më tepër, duke u angazhuar me një gamë të aktorëve, memorializimi në Kosovë duhet të njihet si një mundësi për të sjellë historitë e civilëve të zakonshëm në sferën publike.

Muzeu “District Six” në Cape Town, Afrikë e Jugut, është një shembull i një vendi përkujtimor që ofron një hapësirë edukative për diskurs të vazhdueshëm mbi të kaluarën. Ekzistenca e tij mbështetet në përfshirjen e historive nga civilët e zakonshëm. Ky vend qëndron në kujtim të një komuniteti që dikur ishte dinamik dhe i përzier. Në vitin 1966 autoritet deklaruan që ky vend ishte ‘vetëm për të bardhët’ dhe rreth 60,000 jo të bardhë u dëbuan nga shtëpitë dhe bizneset e tyre. Muzeu u krijua në një nga të vetmet institucione publike që nuk ishte demoluar. Ish-banorët e këtij distrikti u ftuan në muze për të

“Historitë e përditshme mbeten në hije. Ne duhet të mendojmë rreth asaj se si mund të kthejmë vëmendjen tonë te qytetarët e zakonshëm - ne kemi nevojë të dëgjojmë nga një grup më i madh” Intervista 6

³⁴ Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, 2007, f30.

kontribuar me objekte nga e kaluara e tyre dhe për të shkruar kujtimet e tyre të vendeve dhe ngjarjet në një hartë që paraqiste planin origjinal të distriktit. Muzeu ofron një hapësirë brenda të cilit është bërë i mundur dialogu dhe takimi me të tjerët. Kjo tani është një hapësirë për forma tjera të shprehjes publike, duke përfshirë teatrot dhe ekspozitat artistike që fokusohen në promovimin e dialogut historik. Mbanë një arkiv të historive orale duke vepruar po ashtu si një sponsor për programe edukative për të kaluarën. Muzeu ka vepruar gjithashtu si gjykatë përmes të cilit ish-banorët kanë kërkuar dëmshpërblimin për tokë.³⁵ Vende të tilla si kjo ndihmojnë për të sjellur në vëmendjen e publikut histori nga qytetarët e zakonshëm për të kaluarën, duke siguruar një hapësirë për angazhim edukues nga të cilat brezat e ardhshëm janë në gjendje të mësojnë.

Projektet e memorializimit duhet të njihen si mënyrë në të cilën e kaluara mund të përdoret për të stimuluar diskutimin mbi projektet politike përveç promovimit të përkatësisë etnike. Memorialet duhet të gjejnë pika të mirëpuptimit të përbashkët. Për shembull, projektet e memorializimit duhet të kërkojnë adresimin e çështjeve të drejtësisë sociale, respektimin e diversitetit dhe zgjidhjen e problemeve nëpërmjet kanaleve demokratike që i shmangen dhunës. Memorialet duhet të njihen si potencial për të tërhequr vëmendjen për konfliktet e vazhdueshme në mbarë botën. Në vend që të fokusohen në një mesazh të caktuar nacionalist, ato mund të flasin në përgjithësi për përpjektjet më të gjera dhe të gjenerojnë reflektim mbi pasojat e dhunës dhe padrejtësisë.

Një i intervistuar vë në pikëpyetje, "Ne duhet të pyesim, çfarë tregimi janë duke ju treguar memorialet e Kosovës brezave të ardhshëm dhe vizitorëve" (Intervista 2). Është me rëndësi jetike që të mbahet mend se ajo çfarë shfaqet në memoriale është për të ardhmen aq sa për të kaluarën. Simbolika e këtyre memorialeve duhet të vihet në pikëpyetje. Qeveria e Kosovës dhe të tjerët duhet të reflektojnë nëse memorialet ndihmojnë në ofrimin e paqes afatgjatë ose nëse ndihmojnë për të mbështetur një konflikt të fshehur.

“Memorialet duhet të vihen në pikëpyetje – duhet të ketë një ndryshim në mentalitet.”
Intervista 2

Njohja më e madhe për rëndësinë e memorialeve vjen nga një njohje më e madhe e rëndësisë së ballafaqimit me të kaluarën në përgjithësi. Ekziston një nevojë për më shumë dëgjime publike, diskutime publike dhe programe të edukimit joformal që ndihmojnë për të përqëndruar vëmendjen në të kuptuarit e së kaluarës, dhe rëndësinë e ballafaqimit me të kaluarën për të ndërtuar të ardhmen (Intervista 6/7).

³⁵ Baraslou, Judy and Baxter, Victoria. (2007). The Urge to Remember: The Role of Memorials in Social Reconstruction and Transitional Justice Nxitja për kujtim: Roli i memorialëve në rindërtim social dhe Drejtësi Tranzicionale); District Six Museum (Muzeu i Distriktit të gjashtë), <http://www.districtsix.co.za/>, 2015.

7. PËRFUNDIM

Një problem thelbësor është se nuk ka qasje të institucionalizuar të kujtesës në Kosovë. Shumica e memorialeve janë nisma private të ndërtuara ose nga anëtarët e familjes në kujtim të të afërmeve të tyre, ose nga Shoqatat e Veteranëve të Luftës. Nuk ka standarde të cilave u përmbahen memorialet. Për këtë arsye janë përqëndruar kryesisht në individë dhe glorifikimin e UÇK-së. Ka pak debate në lidhje me vuajtjet e përbashkëta të përjetuara gjatë viteve 1990. Estetika e shumicës së memorialeve është e vjetëruar dhe indirerente ndaj qëllimit për marrëdhënie më të ngushta pan-evropiane ose euro-atlantike. Gratë mezi duken në peizazhin e kujtesës në Kosovë. Memorialet nuk ekzistojnë si një proces i angazhimit qytetar dhe bëjnë shumë pak për të edukuar ose vepruar në mënyrë konstruktive si paralajmërim për brezat e ardhshëm. Ka pak dëshmi për diskutim në lidhje me rolin e memorializimit me qëllim të pasqyrimi të një 'vetëdije më të gjerë të përbashkët globale'.³⁶ Institucionet e Kosovës dhe shoqëria civile kanë një rrugë të gjatë për të bërë në drejtim të zhvillimit të një kulture të kujtesës.

Shqetësimet për memorializimin janë të lidhura me çështje të tjera urgjente që lidhen me ndarjen e drejtësisë në Kosovën e pasluftës. Qasja ndaj memorializimit ndoshta pasqyron mënyrën se si është trajtuar trashëgimia e konfliktit. Pas luftës, fokusi i vetëm në drejtësi ndëshkuese dhe roli i Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (ICTY) ka rënë argumentueshëm në kurriz të themelimit paralel të një qasje më restorative dhe me orientim social në ndarjen e drejtësisë (Intervista 6). Ka diskutim minimal në lidhje me rëndësinë e adresimit të së kaluarës në mënyrë gjithëpërfshirëse në Kosovë. Është e rëndësishme për të gjeneruar debat shoqëror që rritë ndërgjegjësimin për nevojën për t'u marrë me të kaluarën. Është pikërisht mungesa e ballafaqimit me të kaluarën ajo që ndihmon në ruajtjen e ndjesisë se konflikti nuk ka mbaruar. Ndjenja se identiteti mbetet i kërcënuar përjetëson dëshirën për të vazhduar mbrojtjen e një identiteti të fortë kombëtar, siç është e qartë në të gjitha peizazhet e tanishme të kujtesës në Kosovë. Pa një qasje gjithëpërfshirëse në adresimin e së kaluarës, nuk ka ndarje të drejtësisë dhe për këtë arsye nuk ka paqe të qëndrueshme.

Siç u tha në fillim të këtij punimi, duhet të miratohen një sërë mekanizmash në mënyrë që të plotësojnë nevojat e atyre që kanë vuajtur gjatë konfliktit dhe për të ndihmuar një proces më të gjerë të shoqërive për tu pajtuar me të kaluarën. Projektet e memorializimit si të vetme, nuk mund t'i ndajnë qëllimet e drejtësisë tranzicionale, por mund të ofrojnë përkrahje. Ato kanë potencial për të krijuar hapësira për angazhim demokratik dhe për të nxitur një angazhim për të drejtat e njeriut te gjeneratat e reja.³⁷ Ato mund ta paraqesin të kaluarën si diçka që nuk duhet t'i lihet fushave të historisë, por si diçka, që nëse nuk trajtohet me ndjeshmëri, mund të shfaqet përsëri. Nëse projektet e memorializimit përvetësojnë metoda që stimulojnë dialogun dhe reflektimin kritik, kanë potencial për të kontribuar në një strategji më të gjerë të drejtësisë tranzicionale.

³⁶ Anne Whitehead, *Memory (Kujtesa)*, 2009, f150.

³⁷ Sebastian Brett, Louis Bickford, Liz Ševenko, Marcela Rios, 2007, f28-30.

8. BIBLIOGRAGRFIJA

Revista Shkencore

Barsalou, Judy and Baxter, Victoria. (2007). 'The Urge to Remember: The Role of Memorials in Social Reconstruction and Transitional Justice' (Nxitja për kujtim: Roli i memorialëve në rindërtim social dhe Drejtësi Tranzicionale), in *Stabilization and Reconstruction*, No. 5.

Di Lellio Anna, and McCurn, Caitlin. (2012). 'Engineering Grassroots Transitional Justice in the Balkans: The Case of Kosovo' (Ndërtimi i themelit të Drejtësisë Tranzicionale në Ballkan: Rasti i Kosovës), *East European Politics and Societies*, 2(1): 1-20.

Di Lellio, Anna and Schwandner-Sievers, Stephanie. (2006). 'The Legendary Commander: The Construction of an Albanian Master Narrative in Post-war Kosovo' (Komandanti Legjendar: ndërtimi i një master-narracioni shqiptar në Kosovën e pasluftës), *Nations and Nationalism* 12(3): 513-529.

Ingimundarson, Valur. (2007). 'The Politics of Memory and the Reconstruction of Albanian National Identity in Post-war Kosovo' (Politika e kujtesës dhe rindërtimi i identitetit kombëtar shqiptar në Kosovën e pasluftës), *History and Memory*, 19 (1): 95 – 123.

Misztal, Barbara. (2010). 'Collective Memory in a Global Age: Learning How and What to Remember' (Memoria kolektive në kohën globale: për të mësuar si dhe çka të kujtohet), *Current Sociology*, 58 (1): 24-44.

Simine, Silke Arnold-de. (2012). 'Memory Museum and Museum Text: Intermediality in Daniel Libeskind's Jewish Museum and W.G Sebald's Austerlitz', *Theory, Culture and Society*, 29 (1): 14-35.

Viejo-Rose, Dacia (2011). 'Memorial functions: Intent, impact and the right to remember' (Funkcionet e memorialit: qëllim, ndikimi dhe e drejta për të kujtuar), *Memory Studies*, 4 (4): 465-480.

Librat

Assman, Jan. (2008). 'Communicative and Cultural Memory' (Kujtesa komunikuese dhe kulturore), in Erll, Astrid and Nünning, Ansgar (eds.), *Cultural Studies: An Interdisciplinary Handbook*. New York: de Gruyler.

Barahona de Brito, Alexandra, Aguilar, Paloma and Gonzalez-Enriquez, Carmen. (2001). *The Politics of Memory: Transitional Justice in Democratizing societies*. (Politikat e kujtesës: Drejtësia Tranzicionale në shoqëritë nw demokrtizim) Oxford: Oxford University Press.

Huyssen, Andreas. (1995). *Twilight Memories: Marking Time in a Culture of Amnesia*. New York: Routledge.

Jones, Andrew. (2007). *Memory and Material Culture* (Kujtesa dhe kultura materiale). Cambridge: Cambridge University Press.

Whitehead, Anne. (2009). *Memory* (Kujtesa). Abingdon: Routledge.

Vegëzat

Brett, Sebastian; Bickford, Louis; Ševenko, Liz; Rios, Marcela. (2007). 'Memorialisation and Democracy: State Policy and Civic Action' (Memorializimi dhe demokracia: Politika shtetërore dhe aktivizmi qytetar), *International Centre for Transitional Justice*, https://www.ictj.org/sites/default/files/ICTJ-Global-Memorialization-Democracy-2007-English_0.pdf, (date accessed 10th September 2015).

Chin, Sharon, Franke, Fabian and Sheri Halpern. (2011). 'A Self-Serving Admission of Guilt: An Examination of the Intentions and Effects of Germany's Memorial to the Murdered Jews of Europe' (Vetë pranimi i fajit: Një shqyrtim nga qëllimet dhe efektet e Memorialit të Gjermanisë ndaj hebrenjve të vrarë të Evropës), *Humanity in Action*, <http://www.humanityinaction.org/knowledgebase/225-a-self-serving-admission-of-guilt-an-examination-of-the-intentions-and-effects-of-germany-s-memorial-to-the-murdered-jews-of-europe>, (date accessed 22nd September 2015).

District Six Museum (Muzeu i Distriktit të gjashtë), <http://www.districtsix.co.za/> (date accessed 23rd September, 2015).

Ereshnee, Naidu. (2006). 'The Ties that Bind: Strengthening the Link Between Memorialisation and Transitional Justice' (Lidhjet që lidhin: Forcimi i lidhjes midis Memorializimit dhe Drejtësisë Tranzicionale). *CSV Centre for the Study of Violence and Reconciliation*. <http://www.csvr.org.za/docs/livingmemory/tiesthatbind.pdf>, (date accessed 2nd July, 2015).

Krasniqi, Elife. (2011) 'Illegalja: Women in the Albanian Underground Resistant Movement in Kosovo' (Illegalja: Gratë në lëvizjen e rezistencës së fshehtë shqiptare në Kosovë), *ProFemina*, Special Edition 2, Summer/Fall. http://www.alterhabitus.org/repository/docs/illegalja_EK_final_AH_272501.pdf, (date accessed 25th August, 2015).

Memoria Abierta, <http://www.memoriaabierta.org.ar/>, (date accessed 23rd September 2015).

Peci, Edona. (2014). 'Kosovo MPs Outrages as War Memorial Closes', *Balkan Transitional Justice*, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-mps-slam-government-on-memorial-neglect>, (date accessed 17th August, 2015).

Revistat

Krasniqi, Elife. (2011) 'Memorials in Kosovo Today' (Memorialet sot në Kosovë), *Made in KS: Periodical dedicated to learning from the past in Kosovo*, 6. Pristina.

Schrader, Lutz. (2012). 'Monuments and politics of identity in the Western Balkans' (Monumentet dhe politika e identitetit në Ballkanin Perëndimor), *Made in KS: Periodical dedicated to learning from the past in Kosovo*, 11. Pristina.

Intervistat

Intervista 1. (23 Korrik 2015). Intervistuesja Jude Sweeney.

Intervista 2. (23 Korrik 2015). Intervistuesja Jude Sweeney.

Intervista 3. (30 Korrik 2015). Intervistuesja Jude Sweeney.

Intervista 4. (3 Gusht 2015). Intervistuesja Jude Sweeney.

Intervista 5. (14 Gusht 2015). Intervistuesja Jude Sweeney.

Intervista 6. (17 Gusht 2015). Intervistuesja Jude Sweeney.

Intervista 7. (27 Gusht 2015). Intervistuesja Jude Sweeney.